



FONDACIONI
ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Përkushtuar Edukimit, Përkushtuar Shëndetit

Prot.n. 098/25

Tiranë, më 09.09.2025

NJOFTIM

Për pozicion të lirë pune: KUZHINIERE

Fondacioni ZKM kërkon të punësojë një kuzhinierë. Pozicioni i punës është provizor duke qenë zëvendësim i lejes së lindjes. Kontrata do të jetë me kohë të plotë, me kohëzgjatje një-vjeçare, me periudhën e provës tre-mujore, duke filluar brenda muajit tetor 2025.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e poshtëshënuara:

1. Diploma e shkollës së mesme.
2. Eksperiencë punë në pozicionin e kuzhinieres.
3. Njohuri të mira në gjuhën italiane.
4. Të jetë një person korrekt, fleksibël, konfidencial, me aftësi shumë të mira komunikuese dhe interpersonalë.

Aplikimi:

Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë dokumentet e kërkuara me e-mail në adresën: personale@fzkm.org, me objekt: Pozicioni i punës: Kuzhinierë, brenda datës 25.09.2025, ora 17.00.

Dokumentet e kërkuara janë:

1. Kërkesë drejtuar Presidentit (në gjuhën italiane);
2. Curriculum Vitae (në gjuhën italiane) i firmosur;
3. Kopje e diplomës dhe certifikatës së notave;
4. Kopje e certifikatave/vërtetimeve që lidhen me kompetencat e profesionit të kuzhinieres dhe me eksperiencën në këtë pozicion.
5. Kopje e kartës së identitetit.

Intervista me kandidatët do të zhvillohet në ditët në vijim e cila do të komunikohet nga Zyra e Personelit të Fondacionit ZKM.

Trajtimi i të dhënave personale:

Të dhënat personale të ofruara nga kandidatët do të mblidhen nga Fondacioni NSBC ekskluzivisht për qëllime të menaxhimit të procedurës së përzgjedhjes, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale.

Fondacioni Zoja e Këshillit të Mirë është i përkushtuar për të siguruar një proces rekrutimi të drejtë, të sigurt, gjithëpërfshirës, respektues dhe pa diskriminim, duke garantuar mundësi të barabarta punësimi për të gjithë.

Presidenti
Fr. Ruggero Valentini

